2	ARKA FILIALI TIRANE	1,545,833
3	ARKA FILIALI DURRES	3,815,385
4	ARKA FILIALI FIER	1,152,526
5	ARKA FILIALI KORÇE	1,496,693
6	ARKA QENDER EURO	4,751,898
		26,000,215

5. Llogari/Kërkesa të arkëtueshme

Në këtë zë paraqiten kërkesat ndaj klientave gjendje të paarkëtuar në 31 Dhjetor 2022. Ato paraqiten me vlerën neto nga zhvlerësimi nga borxhi i keq. Shoqëria nuk ka llogaritur borxh të keq për vitin 2022.

Te drejta të Arkëtueshme njihen si aktive atëherë kur njësia ekonomike bëhet palë e një kontrate dhe, si rrjedhim, ka një të drejtë ligjore për të marrë para.

Te drejtat e arketueshme, ne shumen prej **839,394,616** leke perbehet nga llogari te arketueshme nga faturimet e klienteve per shitje,te klienteve te filialeve ,te klienteve te eksportit dhe te debitoreve te mbartur

Një paraqitje e përbërjes së kërkesave të arkëtueshme ndaj klientave jepet në tabelën vijuese:

Shumat në Lekë	Dif.		
Përshkrimi i Llogarive	31-dhjetor-22	31-dhjetor-21	1-2
Llogari të Arkëtueshme Faturimet	693,099,845	680,625,427	12,474,418
Llogari të tjera Arkët. Investime te tjera	146,294,771	127,356,543	18,938,228
Totali	839,394,616	807,981,970	31,412,646

Dinamika e të drejtave ndaj klientëve gjatë vitit 2022 paraqitet si vijon:

Pershkrimi	31 Dhjetor 22	31 Dhjetor 21
Gjendja 01 Janar 2022	807,981,970	723,395,703
Rritjet Gjate periudhes ushtrimore	31,412,646	84,586,267
Pakesimit gjete periudhes ushtrimore		
Rritje/(pakesime) Diferencat e kembimit		
Gjendja 31 Dhjetor 2022	839,394,616	807,981,970

- Nga aktiviteti i shfrytezimit, ne vlere **693,099,845** leke paraqet kerkesat e arketueshme nga klientet per shitje mall dhe produkt te gatshem.

Vlera prej 693,099,845 lekë perbehet nga :

Kerkesa te arketueshme nga kliente brenda vendit në vlerë 542,042,987 lekë (konkretisht filiali Gjirokaster 113,379,681 lekë; filiali Tirane 325,597,272 lekë; filiali Durres 43,093,900 lekë; filiali Fier 32,000,095 lekë, filiali Korçë 27,972,039lek)

Klientet jashte vendit në vlere 151,056,858 lekë te cilat drejtimi i ka klasifikuar sipas perberjes dhe afateve te arketimit sipas tabelës se meposhtme dhe aneksit Nr 1 bashkangjitur shenimeve.

Një paraqitje e detajuar e këtij zëri jepet në tabelën vijuese:

N/R.	KATEGORIA E KLIENTIT		,PER NJE MUAJ	PER DY MUAJ	ME SHUME SE 1 VIT
1	KLIENTE QENDER	113,379,681	46,286,240	48,253,935	18,839,506
2	KLIENTE FILIALET	428,663,306	134,459,214	180,372,219	113,831,873
3	KLIENTE JASHTJE VENDIT	151,056,858	56,670,324	68,365,690	26,020,844
	SHUMA	693,099,845	237,415,778	296,991,844	158,692,223

6. Kerkesa të arkëtueshme të tjera

Në këtë zë të bilancit paraqiten kërkesat e shoqërisë ndaj të tretëve që nuk lidhen me shitjen e shërbimeve dhe të mallrave.

- *Te tjera*, ne vlerë **146,294,771** lekë perbehet nga:
Kliente per shitje AQT në vlerë 3.200.000 leke;
Parapagime per blerje aqt ne vlere 36,231,052
Premtim kerkesa te arketueshme ne vlere 3.939.350 leke (qe perbehet nga 979.350 leke nga rezervat e shtetit per mallin e konfiskuar ne fil.Korce dhe 2.960.000 leke te vjedhura ne filialin Tirane),
Vlera prej 5,644,854 lekë paraqet debitore te vjeter ardhur nga veprimtaria ne vite.

Vlera prej 32,955,542 lekë janë kërkesa të arketueshme nga parapagime (dhe konkretisht 365,164 leke garanci doganore; 4,784,851 leke paradhënie e paguar për detyrime në doganë, 26,880,870 lekë T.V.SH e paguar tepër, debitorë për dif.malli 442,133 si dhe 482,524. Paradhënie e paguar për reklama mediatiqe (9,600,000 tek Top Chanel; 28,102 tek Media-Vizion 10,500,000 leke tek TV-Klan). Vlera prej 17,955,000 lekë është hua e marrë me kontakte nga Thep Konstruksion.

Vlera prej 26,240,872 leke paradhënie e paguar tepër për Tatim fitimin kundrejt planit të vendosur për vitin 2022.

7. Inventarët

Shoqëria përdor disa lloje të inventarëve të nevojshëm për aktivitetin e vet. Ajo përdor metodën e inventarizimit periodik për evidentimin në kontabilitet të gjendjes dhe lëvizjes të inventarëve. Inventaret janë vlerësuar me kosto e cila është konsideruar nga drejtimi i shoqërisë si me e vogla e krahasuar me vlerën neto të realizueshme. Në koston e inventarit përfshihen vlera e blerjes, taksat doganore dhe transportit dhe çdo shpenzim deri në magazinim., të paraqitura Inventarët në vlerën prej **560,795,135** leke paraqiten si vijon:

Pershkrimi I llogarive	31-dhjetor-22	31-dhjetor-21	Dif. (1-2)
Inventari I lendeve të para	289,445,025	236,720,022	52,725,003
Inventari I produkteve të gatshme	58,152,880	39,646,584	18,506,296
Inventari I mallrave	213,197,230	179,609,785	33,587,445
Totali	560,795,135	455,976,391	104,818,744

- *Lende e pare dhe materjale të konsumueshme*, në vlerë **289,445,025**, përfshin gjendjet e lendeve të para të prodhimit në vlerë 110,137,085 lekë; gjendja e pjesëve të këmimit për riparime në fabrikë në vlerë 54,047,534 lekë, vlera prej 116,242,969 lekë është vlera e materialeve të ambalazhimit të pr. të gatshëm dhe vlera prej 9,017,436 lekë është gjendja e karburantit të përdorur për mjetet e vet ndërmarrjes në fund të periudhës kontable e cila përputhet me inventarin fizik të kryer në fund të vitit.
- *Produkte të gatshme*, në vlerë **58,152,880** leke, përfshin gjendjet e produkteve të prodhuara nga vet ndërmarrja dhe që janë gjëndje në të gjitha magazinat në fund të periudhës kontabile vlerësuar me koston e produktit të gatshëm të dale nga procesi i vet i prodhimit dhe përputhet me inventarin fizik të kryer në fund të vitit.
- *Mallra*, në vlerë **213,197,230** leke, paraqesin gjendjet e mallrave për rishitje në të gjitha magazinat vlerësuar me koston magazinimi dhe përputhet me inventarin fizik të kryer në fund të vitit.

8. Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra

Per vitin 2022 shoqeria nuk ka pasqyruar shpenzime te shtyra.

9. Aktivet Afatgjata

Gjendja dhe shtesat e pakësimet e Aktiveve Afatgjata te shoqerise perbehen nga aktive afatgjata financiare dhe aktive afatgjata materiale.

9.2 Aktivet materiale

Aktivet materiale, ne vlere **823,536,587** leke vlerësohen me kosto historike minus amortizimin. Kosto historike përfshin shpenzimet që i përkasin direkt blerjes së elementëve. Kostot e kryera më vonë përfshihen në vlerën e mbartur të aktivitetit ose njihen si një aktiv më vete, sipas rastit, vetëm nëse është e mundur që ky element të sjellë hyrje të përfitimeve të ardhshme ekonomike në Shoqëri dhe kostoja e këtij elementi të mund të matet me besueshmëri.

Perberja e Aktiveve Afatgjata Materiale për vitin 2022 paraqiten si në tabelën vijuese:

Shumat në Lekë			Dif.
Përshkrimi i Llogarive	31-dhjetor- 2022	31-dhjetor- 2021	1-2
Toka dhe ndertesa	410,940,810	400,741,790	10,199,020
Impiante dhe makineri	374,124,837	233,569,359	140,555,478
Te tjera Instalime dhe paisje	38,470,940	39,772,001	-1,301,061
Totali	823,536,587	674,083,150	149,453,437

Gjendja dhe shtesat e pakësimet e Aktiveve Afatgjata Materiale dhe e amortizimeve të tyre gjatë vitit 2022 paraqiten si në tabelën vijuese:

	Toka, Ndertime	Makineri e pajisje pune	Aktive te tjera Afatgjata	Kompjuter a dhe te ngjashme	AAJoM	Total
Gjendja 31 Dhjetor 2020	517,618,020	744,862,370	185,415,178	102,026,725	6,346,890	1,556,269,183
Blerjet gjatë viti ushtrimor	9,596,972	12,018,968	7,662,577	7,751,175	0	37,029,692
Shitjet gjatë viti ushtrimor			(1,200,000)	-		(1,200,000)
Nxjerrje jashte perdorimit						0
Riklasifikime						0
Pakësime/Shtesa të tjera						0
Gjendja 31 Dhjetor 2021	527,214,992	756,881,338	191,877,755	109,777,900	6,346,890	1,592,098,875
Blerjet gjatë viti ushtrimor	20,040,490	191,683,207	3,514,335	8,696,195	0	223,934,227
Shitjet gjatë viti ushtrimor			-2,046,708			-2,046,708
Nxjerrje jashte perdorimit						0
Riklasifikime						0
Pakësime/Shtesa të tjera						0
Gjendja 31 Dhjetor 2022	547,255,482	948,564,545	193,345,382	118,474,095	6,346,890	1,813,986,394

Pasqyra e ndryshimit të Amortizimit të AAM materiale

	Toka, Ndertime	Makineri e pajisje pune	Aktive te tjera Afatgjata	Kompjuter a dhe te ngjashme	AAJoM	Total
Amortizimii AAM gjendje me 31.12.2020	116,158,601	538,734,867	124,426,420	57,243,052	6,346,890	842,909,830
Amortizimi i periudhes ushtrimore	10,314,601	41,569,240	11,585,017	12,762,847		76,231,705
Humbje nga Testi i vleres gjate periudhes						-
Amortizimi i AAM te shitura			(1,125,810)	-		(1,125,810)
Amortizimi i AAM te Nxjerra jashte perdorimit						0
Amortizimi I AAM të Riklasifikuara						-
Amortizimii AAM gjendje me 31.12.2021	126,473,202	580,304,107	134,885,627	70,005,899	6,346,890	918,015,725
Amortizimi i periudhes ushtrimore	9,841,470	42,863,618	11,681,268	9,997,256	0	74,383,612
Humbje nga Testi i vleres gjate periudhes						0
Amortizimi i AAM te shitura			(1,949,530)	-		(1,949,530)
Amortizimi i AAM te Nxjerra jashte perdorimit						0
Amortizimi I AAM të Riklasifikuara						-
Amortizimii AAM gjendje me 31.12.2022	136,314,672	623,167,725	144,617,365	80,003,155	6,346,890	918,015,725
VKN 31 12 2021	400,741,790	176,577,231	56,992,128	39,772,001	0	674,083,150
VKN 31 12 2022	410,940,810	325,396,820	48,728,017	38,470,940	0	823,536,587

Në bilanc Aktivet Afatgjata paraqiten për çdo grup me vlerën neto pa amortizimin e akumuluar.

Shitja e aktiveve afatgjata të tjera paraqet kryesisht vleftën e cepit dhe formave e fustelave të cilat shiten në Itali tek shoqëria mëmë. Llogaritja e amortizimit të AAM është bërë duke marrë parasysh kohën e hyrjes së AAM. Per aktivet AAM te dala eshte llogaritur amortizim per periudhën e përdorur deri në momentin e daljes jashtë shoqërisë. Normat e amortizimit të përdorura (referoju shënimit 3.5 (ii)), janë në përputhje me kërkesat e SNK 16, dhe SNK 36 për të siguruar një shpërndarje të saktë të kostos së AAM në koston e periudhave që ato përdoren për sigurimin e të ardhurave, dhe janë në nivelin e normave fiskale. Nga përdorimi i normave të amortizimit sipas politikave kontabel dhe atyre fiskale nuk ka ndryshime në shpenzimet e amortizimit nga përdorimi i këtyre metodave dhe normave dhe metodave të amortizimit të përdorura nga shoqëria me ato fiskale, prandaj nuk ka qene e nevojshme llogaritja per tatim të shtyrë mbi fitimin.

10. Pasivet dhe Detyrimet

Perberja e detyrimeve afatshkurtra ,ne vlere **116,081,948** leke paraqiten sipas tabelës se mëposhtme :

Shumat në Lekë			Dif.
Përshkrimi i Llogarive	31-dhjetor- 2022	31-dhjetor- 2021	1-2
Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit	94,330,056	70,722,849	23,607,207
Te paguesh. ndaj punonj.dhe Sig.Shoq.	14,693,025	12,423,211	2,269,814
Detyrime tatimore	7,058,867	8,709,461	-1,650,594
Hua nga Ortaku I vetem			
Totali	116,081,948	91,855,521	24,226,427

11. Te pagueshme ndaj furnitoreve

Ne kete ze te bilancit paraqiten detyrimet ndaj furnitoreve ende te papaguara ne fund te vitit 2022.Detyrimet ndaj furnitoreve ne monedha te huaja jane konvertuar me kursin e dates se fundit te vitit dhe diferencat kane kaluar ne rezultat.Perberja e ketyre detyrimeve paraqiten si vijon

- *Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit*, ne vlere **94,330,056** lekë si me lart, jane diferenca e detyrimeve qe vijne nga mardhëniet që kemi me furnitoret për mall, lëndë të parë për aktive afatgjate dhe shërbime.Vlera prej **94,330,056** lekë përbëhet nga diferenca e detyrimeve(tepricat kreditore) te furnitoreve per mall ne shumen prej 33,024,895 leke;per lende te pare per prodhimin ne shumen 12,670,377 leke ; me tepricen kreditore te furnitorëve për shërbime ne vlerë 38,642,908 dhe tepricat kreditore te furn.per blerje AQT ne vlere 9,991,876 lekë ku një pjesë e faturave parapaguhet dhe një pjesë tjetër e faturave likujdohet sipas afateve një ,dy apo tremujore nga data e faturës ,sipas marrëveshjeve përkatëse.

Keto detyrime drejtimi i ka klasifikuar sipas perberjes dhe afateve te pageses dhe paraqiten sipas tabelës së mëposhtme:

N/R.	KATEGORIA E FURNITORIT	Totali	Deri ne 30-dite	Deri ne 60 dite	Me shume se 60 dite
1	FURNITORE PER MALL	33,024,895	11,574,844	12,196,236	9,253,815
2	FURNITORE PER LENDE TE PARE	12,670,377	4,763,846	7,906,531	0
3	FURNITORE PER AQT+PJ.KEMBIMI	9,991,876	0	6,341,646	3,650,230
4	FURNITORE PER SHERBIME	38,642,908	25,976,056	6,686,742	5,980,110
5	TE TJERA				
	SHUMA	94,330,056	42,314,746	33,131,155	18,884,155

Ne detyrimet per nje muaj peshen me te madhe e zene faturat e furnitoreve per bl.mall PALLAS S.A ne vlere 6,846,464 leke. Ne detyrimet per dy muaj peshen me te madhe e ze furnitori i mallit BENCKISER HYGIENE HOME ne vlere 4,902,114 lekë dhe furnitori i lendes se pare SOYA HELLAS 6,645,433 lekë, ndërsa në detyrimet për më shumë se dy muaj peshen me te madhe e ze furnitori i mallit ION-SA në vlerë 13,178,037 leke.

Dinamika e detyrimeve ndaj furnitoreve paraqitet si vijon:

Pershkrimi	31 Dhjetor 22	31 Dhjetor 21
Gjendja me 01.01.2022	70,722,849	64,553,121
Rritje gjate periudhes ushtrimore	23,607,207	6,169,728
Paksimet gjate periudhes ushtrimore		
Rritje/pakesime, Diferencat e kembimit	0	
Gjendja me 31 Dhjetor 2022	94,330,056	70,722,849

12. Te Pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore

Ne kete ze paraqiten detyrimet per pagat e llogaritura dhe te papaguara per stafin drejtues dhe punonjesit per muajin Dhjetor. Ne fund te vitit 2022 shoqeria ka detyrime per pagat e papaguara ndaj punonjesve te cilat jane paguar ne muajin Janar 2023.

Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore, ne vlere **14,693,025** leke, eshte perfshire detyrimi per paga te punonjesve ne vlerë 4,708,000 lekë dhe sigurimet shoqerore ne vlere prej 9,985,025 lek, detyrime qe i perkasin muajit Dhjetor 2022 sipas liste pageses, dhe te paguara ne muajin Janar 2023.

Perberja e ketyre detyrimeve paraqitet si vijon:

Pershkrimi	31 Dhjetor 22	31 Dhjetor 21
------------	---------------	---------------

Detyrime per paga	4,708,000	2,807,000
Detyrime Sigurime	9,985,025	9,616,211
Total	14,963,025	12,423,211

13. Detyrimet tatimore

Ne kete vlerë paraqiten detyrimet ndaj shtetit per Tatimet e taksat si dhe detyrimet per tatimin ne page dhe burim

- *Te pagueshme per detyrimet tatimore, ne vlere 7,058,867 leke*, paraqesin detyrimet për Tatimin mbi të Ardhurat Personale ,Tatim ne burim per sherbime me fatura te huaja dhe tatim per qerate;

Nje paraqitje e perberjes se ketij zeri jepet ne tabelen vijuese:

Shumat në Lekë		
Përshkrimi i Llogarive	31-dhjetor-22	31-dhjetor-21
Shteti Tatim Mbi të Ardhurat Personale	6,817,991	7,210,315
Shteti Tatim mbi qerane	152,530	132,480
Shteti Tatim në burim	88,346	219,294
Shteti Tatim Fitimi Korrent	0	0
Shteti T.V.SH	0	1,147,372
Totali	7,058,867	8,709,461

14. Detyrime afatgjata –Hua te tjera

Ne kete ze paraqitet detyrimi i shoqerise ne fund te vitit 2022 ndaj aksionerit te saj ne vlere **1,277,572,958** leke si vijon:

- dividendë të pa tërhequr ne vleren prej 1,220,429,758 lekë.
- huadhenie nga ortaku per investime ne filiale ne vlere prej 22,000,000 leke;
- huadhenie nga ortaku per investime ne linjat e prodhimit ne vlere prej 35.143.200 lekë.

15. Kapitallet e veta

Shoqëria ‘ELKA SA’SH.A është rregjistruar në Shqipëri pas një vendimi të gjykates se rrethit Tirane me numër rregjistrimi 24963 dt 16.01.2001. Në këtë rregjistrim shoqëria ka një kapital fillestar të paguar prej lekë 100.000 leke, dhe subjekt i ligjit për shoqëritë tregëtare, gjithashtu ka kryer dhe derdhjen për llogari të kontributit të kapitalit pranë Bankës.

Si e tillë ajo ka aplikur zbatimin e Ligjit për periudhën 2001 në lidhje me rezervat ligjore prej 5% mbi rezultatin që duhet të krijojë shoqëria duke krijuar në vitin 2005 vlerën prej 2,241,442 lekë rezerva ligjore. Pas një rishikimi të statusit ligjor të shoqërisë në vitin 2007 rezultoi që

rregjistrimi i saj si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar nuk permbushte kerkesat e strategjise se drejtimit te shoqerise, si rrjedhojë në vijim 2008 u kërkua ndryshimi i statusit ligjor të saj e rregulluar me vendim te Asamblese. Megjithatë në periudhat në vazhdim, rezultoi se ndryshimi i kryer ishte rregjistruar vetëm si ndryshim emërtimi ndërkaq që kategorizimi në rregjistër ishte përsëri shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe si e tillë subjekt i kërkesave të ligjit për këto shoqëri.

- *Kapitali I nenshkruar* .ne vlere **1,554,250,000** paraqet vleren e kapitalit qe ka shoqeria në fund te vitit 2022,si rezultat i kapitalizimit te fitimeve gjate viteve.

- *Rezerva te tjera*,ne vlere **161,640,766** leke,paraqet rezervat ligjore te krijuara gjate viteve, pasi drejtimi i shoqerise ka ndare nje shume prej 5% te fitimeve vjetore si rezerva ligjore dhe ne fund te vitit 2022,shuma ne bilanc per rezervat ligjore eshte 161,640,766 leke.

- *Fitimi i pashperndare*,ne vlere **23,981,998** leke,paraqet tepricen e llogarise se fitimeve te pashperndara ne fund te vitit 2022.Kjo vlere perbehet nga 23,981,998 leke fitime te pashperndara (ne formen e fitimeve te mbartura si investim ne shoqeri) nga fitimet e vitit 2021 .

- *Fitimi i vitit*,ne vlere 333,589,784 leke paraqet fitimin neto te vitit ushtrimor 2022.Gjate vitit 2022,kompania rezulton me nje fitim neto ne shumen 333,589,784 leke.

Ndryshimet e kapitaleve te veta jane si më poshtë vijon:

Shumat në Lekë		
Përshkrimi i Llogarive	31-dhjetor-22	31-dhjetor-21
Kapitali I nenshkruar	1,554,250,000	1,314,250,000
Primi I lidhur me kapitalin	0	0
Rezerva rivlersimi	0	0
Rezerva te tjera	161,640,766	161,640,766
Fitimi i pashperndare	23,981,998	872,764
Fitimi i vitit	333,589,784	463,109,234
Totali kapitalit	2,073,462,548	1,939,872,764

16 Të ardhurat

Shoqëria i ka paraqitur të ardhurat dhe shpenzimet duke ndërtuar Pasqyrën e të ardhurave sipas natyrës.

16.1 Shitjet neto

Shoqëria realizon të ardhurat nga aktiviteti i saj, dhe konkretisht nga nga shitjet e produkteve te gatshme , nga shitja e mallrave, nga kryerja e shërbimeve, si dhe te ardhura te tjera financiare.

Te ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit per vitin 2022 jane në vlere gjithsej prej **5,419,131,751**leke, sipas tabelës se më poshtme:

Shumat në Lekë

Përshkrimi i Llogarive	31-dhjetor-22	31-dhjetor-21
Te ardhura nga shitja e punimeve dhe sherbimeve	8,582,432	13,282,020
Te ardhura nga shitja e Mallrave	1,857,102,012	1,779,084,529
Te ardhura nga shitje produkte te gatshme	3,553,447,307	3,053,213,889
Totali	5,419,131,751	4,845,580,438

16.2 Te ardhura te tjera te shfrytezimit

- *Te ardhura te tjera te shfrytezimit*, ne vlere **21,569,964 leke** përbëhet nga prodhimi i aktiveve afatgjata materiale 20,040,490 leke; nga shitja e lendeve te para dhe mbetjeve te tyre si (mbetje kuti kartoni;mbeturina patatesh;mbetje mielli;mbetje vaj ushqimor) në vlerë 1,529,474 lekë .

Ne te ardhura te tjera te shfrytezimit ne shumen prej 21,569,964 leke jane paraqitur te ardhurat sipas tabelës me poshte:

Shumat në Lekë		
Përshkrimi i Llogarive	31-dhjetor-22	31-dhjetor-21
Të ardhura nga shitje materialesh dhe furniturash	1,529,474	1,359,230
Te ardhura nga prodhimi i AA materiale	20,040,490	13,279,659
Totali	21,569,964	14,638,889

17. Ndryshimet në inventarin e produkteve te gatshme dhe gjysëm produkteve

- Ne te ardhurat e vitit 2022 jane pasqyruar te ardhura nga ndryshimi ne inventarin e produkteve te gatshme ne vlere **18,506,296 leke**. Te ardhurat nga ndryshimi i gjendjeve ne vlere 18,506,296 leke paraqet ndryshimin e gjendjeve te inventarit te produkteve te gatshme ne fund te vitit krahasur me gjendjet e produkteve te gatshme ne fund te vitit te meparshem.

Shoqeria rezulton te kete rritje te produktit te gatshem ne shumen 18,506,296 leke, vlerë e cila në pasqyre eshte paraqitur ne zerin ndryshime ne inventarin e produkteve te gatshme dhe prodhimit te proces.

Paraqitja jepet ne tabelen vijuese:

Shumat në Lekë		
Përshkrimi i Llogarive	31-dhjetor-22	31-dhjetor-21
Ndryshimi I gjendjes te produktit te gatshem	18,506,296	3,775,170
Totali	18,506,296	3,775,170

18. Shpenzimet e lëndëve të para e materialeve të tjera dhe shpenzimeve te tjera

Në këtë zë të PASH janë përfshirë kostoja e blerjes së materialeve të para dhe ndihmëse të nevojshme për realizimin të prodhimit në vlerën **3,879,855,710** leke. Në këtë zë kostoja e materialeve të konsumuara përfshin çmimin e blerjes së tyre plus dhe të gjitha shpenzimet e kryera për sigurimin e tyre, përfshirë edhe taksat dhe shpenzimet doganore.

Në koston e materialeve të lendeve të para, mallrave etj. janë përfshirë vlera e lendeve të para dhe materialeve të konsumueshme në vlerë prej **3,527,259,495** leke si dhe shpenzimet të tjera që janë pjesë e koston të produkteve të gatshme në vlerë prej **352,596,215** leke.

18.1 Shpenzimet e lëndëve të para e materialeve të tjera të konsumueshme

Një paraqitje e detajuar e përbërjes të zërit lendeve të para dhe materialeve të konsumueshme në vlerë prej **3,527,259,495** leke paraqitet si në tabelën vijuese:

Përshkrimi i Llogarive	31-dhjetor- 22	31-dhjetor- 21
Shpenzime Blerje/mallrash	1,260,772,608	1,206,985,100
Shpenzime Blerje/materiale të para etj.	2,172,905,897	1,835,493,378
Shpenzime Blerje/ karburanti	86,255,560	91,657,632
Shpenzime Blerje/ kancelarie	7,325,430	7,633,021
Ndryshimi i gjendjes së produktit të gatshëm		
TOTALI	3,527,259,495	3,141,769,131

18.2 Shpenzime të tjera të përfshira në koston e lendeve të para dhe materialeve të konsumueshme.

Një paraqitje e detajuar e përbërjes të zërit Shpenzime të tjera të përfshira në koston e lendeve të para dhe materialeve të konsumueshme në vlerë prej **352,596,215** leke paraqitet si në tabelën vijuese :

Përshkrimi i Llogarive	31-dhjetor- 22	31-dhjetor- 21
Shpenzime Blerje/ energjie dhe uje	257,444,070	75,192,151
Shpenzime për blerje të tjera	1,571,155	2,304,989
TOTALI	352,596,215	77,497,140

19. Shpenzime personeli

Në shpenzimet për personelin, janë përfshirë shpenzimet për paga, shpërblime dhe sigurime shoqërore e shëndetësore të llogaritura gjatë vitit 2022.

Gjatë vitit 2022 shoqëria ka llogaritur, deklaruar dhe paguar në përputhje me kërkesat ligjore tatimin mbi pagat, kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetsore për punonjësit.

- Paga dhe shpërblime, në shumën prej **639,855,639** leke ,përfshijnë shpenzimet për paga, në shumën prej **569,587,121** leke të cilat janë shpenz. të njohura që përbehen nga paga të likuid. në banka .

-Në nënzërin e shpenzimeve për sigurimet shoqërore e shëndetsore paraqiten shuma e kontributeve që llogarit dhe paguan shoqëria mbi fondin e pagave të punonjësve në vlerë **70,268,518 leke**. Kontributet janë llogaritur në përputhje me tarifatat dhe mënyrën e parashikuar nga ligji i kontributeve shoqërore e shëndetsore.

Përbërja e nënzërit të shpenzimeve të pagave paraqitet si vijon:

Shumat në Lekë			
Përshkrimi i Llogarive		31-dhjetor-22	31-dhjetor-21
	Pagat	569,587,121	524,995,209
	Shpenzimet e sigurimeve shoqërore	70,268,518	66,628,463
	TOTALI	639,855,639	591,623,672

20. Amortizimi dhe zhvlerësimet

Në këtë zë të shpenzimeve paraqitet shuma e amortizimit të aktiveve afatgjata materiale të shoqërisë. Llogaritja e shpenzimeve të amortizimit është bërë në përputhje me politikat kontabël të shoqërisë. Referoju shënimit 3.5 dhe 9.

Në këtë post të shpenzimeve paraqitet vlera e amortizimit të aktiveve afatgjata materiale.

Shumat në Lekë			
Përshkrimi i Llogarive		31-dhjetor-22	31-dhjetor-21
	Zhvlerësimi dhe amortizimi	74,383,612	76,231,705
	Rënie në vlerë		
	Totali	74,383,612	76,231,705

21. Shpenzimet e tjera të shfrytezimit

Shpenzime të tjera të shfrytezimit, në shumën prej **422,475,171 leke** përfshijnë të gjitha shërbimet nga të treta në shumën prej 400,710,371 lekë si dhe shpenzime të tjera operative në shumën prej 21,764,800 leke, si me poshtë :

21.1 .Shërbimet e kryera nga të tretët

Në shërbimet e kryera nga të tretët në shumën prej **400,710,371 leke** janë përfshirë shpenzimet dhe shërbimet të kryera nga të tretët, sipas tabelës së mëposhtme: Në vlerën **32,425,526 leke** (llog.615101;61501;615105;615102;615104;615301,615302) janë përfshirë shp. për pj. këmbimi e riparime automj. 17,205,167 lekë; shërbime miremb.fabrikë nga të treta 2,965,289; pjesë këmbimi për fabrikën 3,646,001 lekë; riparim ndërtesë 3,795,001 lekë dhe mirëmbajtje e

kasave fiskale 4,814,068 lekë. Ne vlerën **156,039,368** lekë janë shp. per reklama, te perbera nga reklama mediatike 42,616,604 lekë dhe reklama jo mediatike 113,422,764 lekë te perbera nga sherbim market. nga printime adezive te # dhe promoci. Në shpenzime të ndryshme nga te trete (llog. 61801; 61802, 61804, 61805, 61813; 61821, 61810; 61812; 61817, 6215; 61815; 61816; 61201; 67215, 61205). ne vlere **76,524,567** përbëhen nga sherbime te ndryshme dhe me tatim ne burim si dhe nga shpenz. per komisione nga sherbim marketingu; subvecone e ndihma; autongarkese ne blerje; shpenzime te # te pazbritshme; nga personel jashte njesise dhe rimar. e vl. mbetur te AQT-ve të pakësuar. Në shpenzime transporti ne vlerë **96,716,335** lekë jane transportet neper filiale dhe transportet e eksportit me fatura te pag. nga banka.

Përbërja të shpenzimeve të tjera te kryera nga te trete paraqitet si vijon:

Perberja e ketij zeri te shpenzimeve paraqitet si vijon: Shumat në Lekë

Përshkrimi i Llogarive	31-dhjetor- 22	31-dhjetor- 21
Shpenzime qeraje	13,982,843	12,934,531
Shpenzime udhetimi e dieta per.	2,417,592	1,499,380
Shpenzime pjese kembimi e riparime	32,425,526	42,021,196
Shpenzime siguracione mjetesesh	7,562,346	6,702,077
Shpenzime reklame meiatike dhe jo med.	156,039,368	163,312,773
Shpenzime te ndryshme te pazbritshme	5,661,126	4,397,153
Shpenzime sherbimesh nga te trete	70,863,441	69,073,484
Shpenzime telefoni, postare, G.P.R.S	6,651,247	6,168,855
Shpenzime transporti	96,716,335	84,845,110
Shpenzime koncens. lishenca e patenda	2,818,665	3,291,024
Shpenzime per komisione bankare	5,571,882	5,075,371
TOTALI	400,710,371	399,320,954

21.2 Shpenzime të tjera operative

Në shpenzimet te tjera operative ne vlere prej **21,764,800** leke janë përfshirë shpenzimet e kryera për kuota anëtarësimi, përfaqësimi, pritje përcjellje dhe sponsorizimi, shpenzimet korrente të zyrës (llog. 61804; 61811, 61820) vlera e te cilave nuk kalon 0.3% te qarkullimit; dhe shpenzimet për taksat pa përfshirë tatim fitimin apo TVSH e të tjera tatime e taksa që aplikohen mbi qarkullimin.

Përbërja të shpenzimeve të tjera operative paraqitet si vijon:

Shumat në Lekë

Përshkrimi i Llogarive	31-dhjetor-22	31-dhjetor-21
Shpenzime Anëtarësimi, përfaqësimi, pritje përcjellje dhe sponsorizimi	13,684,405	14,536,232
Shpenzime për taksat (përfshijë TVSH, Akcizat, Tatim Fitimi)	8,080,395	9,929,494
Totali	21,764,800	24,465,726

22. Të ardhurat dhe shpenzime për interesa

Te ardhura te tjera, me vlere **32,174,480** leke sipas tabelës së mëposhtme, perbehen nga : nga skondot ne faturat e furnitoreve dhe tepricat e tyre paguhen me Banke llog.76801 në vlerë 28,650,111 leke ;dhe fitim nga kembimet valutore llog.76901 ne vlerë 3,524,369 leke;

Përbërja e këtij zëri paraqitet si vijon:

Shumat në Lekë		
Përshkrimi i Llogarive	31-dhjetor-22	31-dhjetor-21
Te ardhura nga interesat	-	-
Të ardhura te tjera financiare	28,650,111	29,309,729
Te ardh.nga këmbimet valutore	3,524,369	4,254,894
Te ardh.nga azhorn.i arkes+bankes	0	0
SHUMA	32,174,480	33,564,624

23 Shpenzimet financiare

Shpenzime financiare ,ne shumen **81,354,767** leke, pasqyrojne shpenzimet financiare sip.tabeles se meposhtme qe ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve(PASH) paraqiten si shpenzime financiare ne vlerë 81,354,767 leke;te cilat perbehen nga:

- skondot ne faturat e klienteve te Eksportit llog 668;(kredit note) ne vlerë 5,656,294 leke;
- humbjet nga kurset e kembimit llog.66901 ne vlere 75,698,473 leke ;

Shumat në Lekë		
Përshkrimi i Llogarive	31-dhjetor-22	31-dhjetor-21
Shpenzime te tjera financiare	5,656,294	2,620,428
Humbje nga Kurset e këmbimit	75,698,473	38,409,271
Humbje nga azhorn.arkes/bankes		0
SHUMA	81,354,767	41,029,699

23.1.Fitimet dhe humbjet nga këmbimi

Fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit të pasqyruara sip.tabelave më sipër si dhe ne pasqyrën e te ardhurave dhe shpenzimeve (PASH),paraqiten të detajuara si më poshtë.

Shumat në Lekë		
Përshkrimi i Llogarive	31-dhjetor-22	31-dhjetor-21
Humbje nga Kurset e këmbimit	38,409,271	38,409,271
Humbje nga azhorn.arkes/bankes	0	0

Shuma

38,409,271

38,409,271

24. Tatimi aktual

Shoqëria ka rezultuar me një fitim kontabël para tatimit prej **393,457,592** lekë dhe fitim neto pas tatimit prej 333,589,784 lekë. Për llogaritjen e rezultatit tatimor të vitit 2022 shoqëria ka bërë rregullimet e nevojshme fiskale, duke konsideruar si të panjohura për qëllime fiskale një sërë shpenzimesh. Fitimi i tatueshem i shoqërisë për vitin 2022 rezulton **399,118,718** lekë.

24.1 Shpenzime Tatim Fitimi**Shpenzime Tatim Fitimi kontabël**

Shpenzimi tatimi mbi Fitimin kontabël llogaritet në përputhje me legjislacionin tatimor në Republikën e Shqipërisë në fuqi në datën e mbylljes së pasqyrave financiare 15% në 2022. Konkretisht fitimi i vitit para tatimit është $393,457,592 \text{ leke} * 15\% = 59,018,639$ lekë.

Përshkrimi i Llogarive	31-dhjetor-22	31-dhjetor-21
Shpenzim (përfitim) Tatim Fitimi Kontabël	59,018,639	81,843,164
		0
	59,018,639	81,843,164

24.2 Shpenzime Tatim Fitimi Fiskal

Shpenzimet e Tatim Fitimit Korrent janë rezultat i zbatimit të legjislacionit tatimor në fuqi duke shtuar shpenzimet e pazbritshme dhe janë paraqitur si më poshtë. Duke shtuar tek fitimi para tatimit në vlerë prej 393,457,592 lekë dhe shpenzimet e panjohura në vlerë 5,661,126 lekë $= 399,118,718 * 15\% = 59,867,808$ leke:

Përshkrimi i Llogarive	31-dhjetor-22	31-dhjetor-21
Tatim Fitimi Korrent	59,867,808	82,511,860

Në shpenzimet të panjohura janë përfshirë shpenzimet sipas tabelës të mëposhtme:

	Viti 2022	Viti 2021
Shpenzime me dokumente jo të rregullta e të tjera	5,661,126	4,457,971
<i>Shpenzime të tjera</i>		

Shpenzime pritje e perfaqësimit te normave
Gjoha Penalitete e te ngjashme

Fitimi i tatueshëm i vitit 2022	399,118,718	550,079,065
Norma e tatimit aktual mbi fitimin	15%	15%
Tatimi aktual mbi fitimin	59,867,808	82,511,860
Shpenzimi kontabel i tatimit mbi fitimin	59,867,808	82,511,860
Fitimi neto i Bilancit	333,589,784	463,109,234

- *Fitimi i vitit* para tatimit, ne shumen **393,457,592** leke paraqet diferencen midis te ardhurave dhe shpenzimeve qe per vitin 2022 rezulton me fitim bruto ne vleren 393,457,592 lek.

Te ardhurat 5,472,876,195 leke – shpenzimet 5,079,418,604 leke= **fitimi bruto 393,457,592** leke **7.19%**

- *Fitimi i vitit*, ne shumen **393,457,592** leke paraqet diferencen midis te ardhurave dhe shpenzimeve qe per vitin 2022 rezulton me fitim neto ne vleren 333,589,784 leke, pasi eshte llogaritur dhe zbritur tatimi mbi fitimin

Te ardhurat 5,472,876,196 leke– shpenzimet 5,139,286,412leke = **fitimi neto 333,589.784** leke , **6.1%**

25. Transaksionet me palet e lidhura

Shoqëria është e zotëruar në masën 100% nga aksioneri i vetem Z.Lefter Kallo.

Shoqëria ka identifikuar si palë të lidhura gjithë shoqëritë e zotëruara nga ortakut i vetem Lefter Kallo ashtu sic parashikohet nga SNK 24: Palet e lidhura.

Në paraqitje te shumave të transaksioneve të kryera me palët e lidhura gjatë vitit 2022 paraqitet si vijon:

Transaksionet me palet e lidhura :

Transaksione shitje me palet e lidhura	2022	2021
Interelka Ltd	133,849,106	85,192,665
Elka Internacional Shpk	212,420,335	168,557,587
Elka Intenational Doeel	80,542,539	95,921,118
Dariba Shpk	240,000	240,000
Totali	426,811,980	349,911,370

Transaksione blerje me palet e lidhura	2022	2021
Interelka Ltd	2,614,788	2,478,466
Elka Internacional Shpk	-	-
Elka Intenational Doeel	-	-
Dariba Shpk	9,759,790	10,991,027
Totali	12,374,578	13,469,493

Nje paraqitje e gjëndjeve më 31.12.2022 te llogarive me palët e lidhura jepen në vijim:

Tepricat ne Fund te vitit	31.12.2022	31.12.2021
1. Llogarite te Arketueshme	17,809,546	23,076,683
2. Llogari te Pagueshme per furnizime	674,269	1,146,329
3. Hua Afatgjata		
Totali	18,483,815	24,223,012

a) Rakordim i të ardhurave me deklarimet për Tatimin mbi vlerën e shtuar

Përshkrimi	31-dhjetor-22	31-dhjetor-21
Të ardhurat nga shitjet e tatueshme me shkalle 20%	4,462,661,037	4,066,514,826
Eksporte/furnizime me shkalle 0%	969,693,075	781,210,298
Shitje pa tvsh	1,676,728	4,749,831
Autongarkese e TVSH-se në shitje	6,670,875	7,744,372
TOTALI I TE ARDHURAVE PASQYRUAR NE FDP.	5,440,701,715	4,860,219,327
DIFFERENCA	0	0

Totali i te ardhurave te deklaruar ne PASH eshte 5,472,876,195

Diferencat ne vlere prej 32,174,480 leke me shumen e deklaruar ne FDP jane:

Përshkrimi	31-dhjetor-22	31-dhjetor-21
Te ardhura nga fitimet nga kembimet valutore dhe azhornimet.	3,524,369	4,254,894
Të ardhura nga interesa bankare	-	-
Te ardhura te tjera financiare		29,309,729
	28,650,111	
TOTALI I TE ARDHURAVE	32,174,480	33,564,624

Keto te ardhura nuk jane pasqyruar në FDP.pasi nuk ka rubrike te vecante per keto zera dhe jane vlera qe nuk mund te deklarohen ne periudha mujore pasi jane ne vartesi te kursit te kembimit ne fund te vitit.

Tatim Fitimi

Tatimi mbi Fitimin llogaritet në përputhje me legjislacionin tatimor në Republikën e Shqipërisë. Norma aktuale e tatimit mbi të ardhurat llogaritet bazuar në ligjet për tatimet që janë në fuqi në datën e ndërtimit të bilancit kontabël prej 15%. Ne shumen e fitimit të tatueshem janë pasqyruar dhe shpenzimet e perjashtuara ne shumen 5,661,126 leke. Vlera prej 1,039,889 lekë përbëhet nga gjoba dhe penalitete; 1,470,434 lekë janë shpenzime nga mbyllja T/burim dhe qerases; 646,626 lekë shpenzime me fatura jo te rregullta; dhe 2,407,360 lekë janë shpenzime per blerje te # per te trete ne forme dhuratash, 96,817 leke shp. te panjohura energjie Zerat e ketyre shpenz. paraqiten si me poshte:

- 1.-Shpenzime te kryera me fatura jo te rregullta ne vlere... 4,621,237
- 2.-Shpenzime per gjoba te ndryshme ne vlere..... .1,039,889 leke

26. Ngjarjet mbas datës së bilancit

Pas datës së bilancit kontabël nuk kanë ndodhur ngjarje që mund të kërkojnë ndonjë rregullim ose prezantim në pasqyrat financiare.

PER FINANCEN

(QEMAL LUZI)

PER DREJTIMIN E SHOQERISE

(ILIA JORGJI)